



RAPORTI I PUNËS

21 prill 2023- 09 shtator 2024

Gjenevë, 09 shtator 2024

AKTIVITETET

1. Pjesëmarrja e dytë në Aulona Inter-Folk Festival në Vlorë



Për të dytin vit me radhë, grupi muzikor "Hareja" që vepron në kuadër të KShGj-së mori pjesë në festivalin ndërkombëtar «Aulona Inter Folk Festival». Këtë vit si grup nderi jashtë konkurimit. Për tri ditë me radhë, në datat 6, 7 dhe 8 maj 2023, grupi ishte përkrah grupeve të tjera pjesëmarrëse që vinin nga Austria, Sllovakia, Greqia, Turqia, Zvicra, Ukraina, Maqedonia e Veriut, Kosova e Shqipëria.

Në shenjë falenderimi për pjesëmarrjen e shkëlqyer në këtë festival, grupit muzikor "Hareja" iu nda edhe një Diplom nga organizatori i këtij festivali Z: Sejmen Gjokoli- "Mjeshtër i madh".

Si gjithmonë, KShGj-ja përkrahi financiarisht pjesëmarrjen e grupit muzikor "Hareja".

2. Festa e Flamurit

Mërgata shqiptare në Gjenevë kremton Festën e Flamurit



Me rastin e 28 nëntorit nga shoqatat: KSHGJ-ja, LAPSH, SHOQATA E STUNDETËVE SHQIPTARË të GJENEV, RINIA-CONTACT, ANSAMBLI GËZUAR dhe shoqata ZHEGRA u kremtua me një pjesëmarrje madhështore Dita e Flamurit tonë kombëtar.

Ditëlindja e shtetit shqiptar, është ngjarja më e bukur për çdo bashkëkombës, kudo që jeton, në Shqipëri dhe jashtë saj. 28 nëntori kjo festë e shumëfishtë e flamurit, pavarësisë, ditëlindjes së komandantit legjendar Adem Jashari dhe daljes në skenë të UCK-së festohet e përkujtohet gjithandej nga jetojnë e veprojnë shqiptarët.



Edhe këtu në qytetin e Gjenevës me një program të pasur artistik u shënuar festa jonë mbarëkombëtare. Pas intonimit të himnit kombëtar programi filloi me premierën e këngës "Mos harro" - një mesazh për ruajtjen e trashigimisë sonë shpirtërore e realizuar nga producenti Elion Krasniqi i cili njëherit së bashku me babain e tij artistin Shpejtim Krasniqi edhe e interpretuan atë. Menjëherë pas tyre pasoi një program i pasur me këngë e poezi nga fëmijët e LAPSH-it i pregaditur nga mësueset e tyre.

Përfaqësuesi i Këshillit Organizativ të këtij manifestimi z. Liburn Mehmetaj duke përshëndetur të pranishmit dhe duke ju uruar festat e nëntorit dha një kronologji të organizimeve dhe programit i cili ishte përgatitur me këtë rast.



Më pas, protagonist të skenës bëhen Grupi "Rinia Kontakt", Grupi muzikor "Hareja", Ansambli "Gëzuar" të cilët dhanë pika të pasura artistike para një publiku madhështor.

Kryetari i ri i Komunitetit Shqiptar të Gjenevës, z. Nasuf Nuhiu falënderoi të gjithë për pjesëmarrjen e tyre. Ai në vazhdim deklaroi se Festa e Flamurit është edhe krenaria e jonë kombëtare ku shumë kush i ka kontribuar ruajtjes dhe ngritjes së k'ti flamuri dhe idealeve tona, në veçanti dëshmorët e kombit. Z. Nasuf Nuhiu bënte thirrje që secili nga ne duhet të shërbejmë çështjes sonë kombëtare dhe atdheadashurisë në realizimin e të drejtave tona.

Po ashtu në vazhdim të këtij programi, nga kryetari Z. Nuhiu u ndan edhe mirënjohje për studentët shqiptarë në shenjë falenderimi për të arriturat e tyre në fushën e shkencës dhe dijës. Pas kësaj, programi vazhdon me një buqetë këngësh festive nga artistë që jetojnë e veprojnë në Gjenevë. I gjithë ky program nën udhëheqjen artistike të znj. Afërdita Krasniqit.

Festa pas programit artistik vazhdoi me solistin e mirënjohur Nimon Mushkolaj i cili me zërin dhe pikat e përzgjedhura madhështoj fetën tonë.

3. Pritja e Shkurte Fejzës për 50 vjetorin veprimtarisë artistike



Me datën 10 shkurt 2024, bashkë me "Ansambli Gëzuar" në Gjenevë, me rastin e jubileut të 50 – me këngën dhe skenën artistike të solistes shumë të çmuar,

organizuar një befasi madhështore për artisten e vlerave të mëdha shqiptare – Shkurte Fejza.



Valltaret nga "Ansambli Gëzuar", me spikatje nga veshjet kombëtare, pastaj prindër dhe anëtarë kryesisë të shoqatës tonë, të mbledhur në sallën "Villa Tachinni" në Gjenevë me një prezencë madhështore dhe nën përcjelljen e këngës "Mora fjalë" si dhe duartrokitje të shumta, pritën artisten dhe bilbilin e këngës shqipe, të adhuruarën Shkurte Fejza. Kjo prezencë dhe kjo pritje aq e ngrohtë sikur emocionoj solisten e cila në shenjë falënderimi i përshëndeti ngrohtësisht mbi njëqind të pranishëm të cilët ndodheshin aty.



Fjalën hyrëse e mori Kryetari i "Ansambli Gëzuar" Fadil Avdija i cili duke përshëndetur me fjalë mirënjohje Shkurten dhe vajzën e sajë Gresën, shpalosi para tyre dhe të pranishmëve disa pika nga aktiviteti i këtij Ansambli dhe ne veçanti i falënderoj prindërit për angazhimin e tyre. Duke e falënderuar solisten e cila bashkë me të bijën e saj i kishin nderuar me prezencën e tyre, ai në emër të "Ansambli Gëzuar" e ftoi Safije Bekiri me djalin e saj Argjendin që në mënyrë simbolike t'i ofrohet një bukë shtëpie e gatuar nga kjo nënë. Kjo bukë përçonte mesazhin e motës shqiptare "Bukë, kripë e zemër".

Në vazhdim, kryetari Avdija fton në skenë artisten e mirënjohur Afërdita Krasniqi e cila i njofton të pranishmit me programin e kësaj befasi. Ajo duke dhënë një përmbledhje të aktiviteteve iu drejtua Shkurte Fejzes me fjalët: "Jeni ju Zana e bukur, që me zërin e bilbilit, me tingujt e këngëve tuaja për pesëdhjetë vite pa ndalur na dhurove, shumë dashuri, e ngrohtësi dhe në ditët më të acarta. Na hoqe mërzinë duke na i gëzuar zemrat me optimizëm, e duke na i kujtuar bëmat e historisë sonë të lavdishme..."

Më pas, programi artistik filloi me dy valle nga valltaret e mrekullueshëm të "Ansambli Gëzuar". Në vazhdim "Grupi Hareja" interpretoi dy këngë: "O Bacë Ademi" dhe këngën "N`xhamadanin vija vija", të shoqëruar nga violinistja dhe kitaristi Rina dhe Bashkim Krasniqi. Kënga "Dardania ime" e producentit Elion Krasniqi dedikuar pavarishtë së Republikës së Kosovës ishte premierë për nder të solistes, kënduar nga Ejona Bytyqi dhe

Elion Krasniqi. Programi artistik përmbillet më këngën e kënduar nga Babë e birë "Mos Harro" të interpretuar nga Shpejtim dhe Elion Krasniqi.

Në vazhdim të programit, Zonja Afërdita Krasniqi fton në skenë Kryetarin e "Komunitetit Shqiptar" të Gjenevës, Zotëri Nasuf Nuhiun bashkë me solisten e madhe Shkurte Fejza. Kryetari Nuhiu, pasi përshëndeti dhe falënderoj bilbilin e këngës shqipe tha se kam nderin dhe kënaqësinë që në emër të "Komunitetit Shqiptar" të Gjenevës me rastin e 50 vjetorit të kontributit të dhënë në artin Shqiptar t'i ndajmë mirënjohjen tonë Zonjës Shkurte Fejza për mbjelljen, kultivimin dhe përcjelljen brez pas brezi të atdheadashurisë. Gjithashtu e madhja Shkurte Fejza u nderua edhe me librin e Zotëri Ali Mehmetit, "Në kërkim të idesë". Asaj po ashtu iu dhura edhe një kampanë me simbole të qytetit të Gjenevës dhe shtetit Helvetik si dhe një buqetë lulesh. Në përfundim të kësaj pritje madhështore, me duartrokitjet e shumta në skenë u soll edhe një torte befasi e përgatitur nga Afërdita Krasniqi enkas për pesë dekada me këngën dhe artin e mirëfilltë të mbretëshes sonë.

4. Dita e Dëshmorëve me prezantimin e librit "Eskadronët e vdekjes" të autorit Bardhyl Mahmutit



Me 7 maj 2024 në qytetin e Gjenevës, KSHGJ-ja në bashkpunim me shoqatën e Studentëve Shqiptarë të Gjeneves shënuan Ditën e Dëshmorëve të Kombit shqiptar, në prani të shumë veprimtarëve dhe mërgimtarëve tanë, ku edhe u prezantua romani që jep kronologjin e gjenocidit serb në Kosovë "Eskadronët e Vdekjes" të autorit dhe veprimtarit Bardhyl Mahmuti

Promovimin e këtij libri me praninë e tyre kishin ardhur për ta nderuar shumë veprimtarë dhe aktivistë të jetës sonë kulturore e politike. Konsulli i Republikës së Kosovës në Gjenevë, zotëri Rexhep Bajraktari, Ambasadori Ramadan Avdiu, të burgosur politik dhe veprimtar si Ramadan Pllana e të tjerë, të cilët në hapjen e këtij tubimi u përshëndetën dhe u falënderuan për pjesëmarrje nga Kryetari i shoqatës Komuniteti Shqiptar në Gjenevë zotëri Nasuf Nuhiu.

Kryetari i shoqatës "Komuniteti Shqiptar në Gjenevë" pasi përkujoj gjithë dëshmorët e kombit, ai duke shpalosur një historik të veprimeve të shoqatës, me theks të veçantë potencoi bashkëpunimin me Shoqatën e Studentëve të cilët siç tha ai ky bashkëveprim ka një domethënie të veçantë të aktiviteteve.

Sot në ditën kur kujtojmë dhe nderojmë dëshmorët e kombit, të cilët janë pika më e lavdishme e historisë sonë kombëtare, kur emrat e tyre me pietet janë të përcjellë në këngë shqipe, të përmendur në rrugët e atdheut, në prozën dhe poezinë shqipe, monumente historike, si të tillë ata janë trashëgimia jonë kombëtare që do përcillet nëpër breza – tha Kryetari Nasuf Nuhiu dhe shprehu gëzimin se ky promovim i romanit të autorit Mahmuti bëhet pikërisht në këtë përvjetor.

Në vazhdim të promovimit zotëri Ali Mehmeti, themelues i KSGJ-së duke bërë një vështrim analizues mbi romanin "Eskadronët e Vdekjes" u ndal nëpër periudhat kohore, personazhet e romanit dhe mesazhin e qartë për brezat të cilët nuk e kanë përjetuar luftën dhe këtë zezonë të ushtruar serbe mbi shqiptarët deri në përmasat e gjenocidit dhe tentimit të zhbërjes kombëtare. Ky roman dokumentues, i shkruar me një gjuhë të bukur artistike, me personazhe reale nxjerrin në pah jo vetëm shovinizmin serbë por, dëshmojnë qartë se deri ku mund të shkonte tërbimi serbë duke vrrarë e masakruar njerëz madje edhe fëmijë të pafajshëm.

Në bazë të vlerave që kap kjo vepër letrare, mendoj se si e tillë ajo duhet të jetë në çdo vatër shqiptare, çdo institucion dhe të i prezantohet botës si e tillë, madje ajo duhej të futet edhe në planë programet e domosdoshme mësimore, për brezat që vijnë të njihen për masakrat,

gjenocidin dhe pushtimin serbë. Zotëri Ali Mehmeti, përmendi edhe dredhitë e pushtuesit i cili bëri përpjekje që veprimet të cilat i kishte zhvilluar vet mbi popullin shqiptar u mundua të ua atribuonte Ushtrisë çlirimtare të Kosovës, siç ishte rasti me propaganduesin e gënjeshtreve senatorin Dick Marty.

Autori Bardhyl Mahmuti, duke bërë një punë krijimtarie të mirëfilltë, ka arritur të sjellë dëshmi dhe fakte mbi këtë ngjarje. Ai duke grumbulluar gjithë materialin e atyre që kanë përjetuar këtë skëterrë të pushtuesit, dhe duke sjellë dëshmi të gjalla duke i portretizuar edhe artistikisht, ka arritur të sjellë një kryevepër jo vetëm letrare por, shumë jetike dhe të domosdoshme për historiografinë shqiptare – tha në analizën dhe vështrimin e veprës zotëri Ali Mehmeti.

Pas vështrimit mbi librin për nderë të ditës së dëshmorëve të kombit dhe të këtij tubimi grupi "Hareja" prezantuan këngën për Skënderbeun të shoqëruar nga kitaristi Bashkim Krasniqi. Dhe pas pikave artistike prezantohet filmi dokumentar "Masakra e Poglekut" ku me datë 17 prill të vitit 1999 ushtria barbare serbe kishte masakruar dhe vrarë e më pas edhe djegur kufomat e 53 shqiptarëve civil, duke filluar nga foshnja gjashtë muajsh e deri tek plaku 75 vjeçar.




Autori i këtij libri zotëri Bardhyl Mahmuti, duke falënderuar organizatorët për mundësinë e këtij promovimi dhe shpalosjen e kësaj vepre tha: Kjo është vetëm njëra nga dëshmitë e tragjedisë së popullit të Kosovës. Qëllimi ynë duhet të jetë të dokumentojmë se këto krime dhe kriminelët e këtyre veprave herët e vonë duhet të nd

Propaganda serbe duke mëtuar të përgënjeshtroi të vërtetat mbi krimet që forcat serbe kanë kryer gjatë luftës në Kosovë, edhe sot nuk denjon për të dhënë pasqyrime të rrejshme mbi luftën e Kosovës. Në fund duhet theksuar se historia e njerëzimit ka njohur edhe më parë krime dhe tentime për shfarosje të popujve.

Nënat, motrat, dhe fëmijët e mbetur jetim, nuk kërkojnë hakmarrje por ata duan drejtësi. Drejtësi nuk mund të quhet kur mëtohet të barazohet kriminelin dhe viktimën. Drejtësi nuk quhet kur, protagonistët e ployës enden të lirë dhe madje selisin plane për krime të reja...Drejtësi nuk është kur ende, shumë njerëz të vrarë ndodhen në listat e njerëzve të pagjetur... Përfundoj shkrimtari dhe autori i kësaj vepre zotëri Bardhyl Mahmuti. Në fund autori të pranishmëve u dhuroi secilit librin e tij romanin "Eskadronët e vdekjes".

Në fund të këtij organizimi talentja e re e muzikës, Ejona Bytyqi shoqëruar në piano nga Elion Krasniqi zgjodhi disa pika muzikore dhe më pas solistja Afërdita Krasniqi me këngën "Vaji i Nënës" përmbylli këtë ngjarje ku në fund për gjithë të pranishmit ishte shtruar një aperitiv me dolli e diskutime që do ta përmbyllnin shënimin e 5 majit ditës së dëshmorëve të kombit.

5. Regjistrimi i popullatës



Veprimtarët e dalluar të Komunitetit shqiptar të Gjenevës, përpos aktiviteteve kulturore, artistike e atdhetare, mbështetjen e mësimi shqip, bashkëpunimit për rrjetëzimin e fuqizimin e komunitetit shqiptar në Gjenevë dhe Zvicër, shënimin e datave historike dhe nderimin e të gjithë dëshmorëve pa dallim, së fundi me vetiniciativë kanë kontribuar suksesshëm edhe për regjistrimin e qytetarëve të Kosovës, të cilët jetojnë në Gjenevë dhe kantonet përreth. Këtë aksion ata e bënë në bashkëpunim me Konsullatën e Republikës së Kosovës në Gjenevë.

Kështu, për t'ju bërë krah proceseve institucionale dhe përmbylljes së procesit të pavarësisë e shtetësisë, në këtë rast për të qar përpara regjistrimin aktual të qytetarëve të Republikë së Kosovës edhe jashtë atdheut, Shoqata – Komuniteti shqiptar i Gjenevës përmes të dy nga drejtuesit e saj, Nasuf Nuhiu e Linda Rexhaj Maliqi, me katër kujdestari vullnetare janë vu në shërbim të Konsullatës së Republikë së Kosovës në Gjenevë e rrethinë për të mbështetur bashkatdhetarët, që kanë nevojë për të kryer obligimin qytetar, gjegjësisht regjistrimin e tyre dhe familjarëve të tyre në diasporë. Kështu falë këtij angazhimi përkushtues të këtyre dy veprimtarëve të mirënjohur të Komunitetit shqiptar të Gjenevës,

brenda 4 ditëve u arrit që të regjistrohen edhe rreth 200 qytetarë të Kosovës, kryesisht nga pjesa frëngjishtfolese e Zvicrës, nga këta rreth 30% edhe qytetarë nga Franca fqinje. Mirënjohje e respekt për të gjithë ata që u angazhuan vullnetarisht në mbështetje të këtij procesi institucional të Republikës së Kosovës.

6. PJESMARRJA E GRUPIT "HAREJA" NË KONCERTIN NË LUCERN

Më 13 prill u mbajt koncerti me nismën e shoqatës "Hora e Skënderbeut" dedikuar vendosjes së shtatores së Skënderbeut në Horën e Arbëreshëve. Kësaj nisme i janë bashkuar 16 shoqata e ansamble nga të gjitha anët e Zvicrës, mes tyre edhe grupi ynë "Hareja". Me këtë rast u mbajt një koncert i madh ku u shfaq një program i pasur kulturor me këngë e valle si dhe kishte të ftuar special të kësaj mbrëmje. Mjetet e grumbulluara nga biletat hyrëse dhe donacionet e tjera janë të dedikuar për projektin e vendosjes së shtatores së Skënderbeut në Horën e Arbëreshëve.



Shtatorja e Skënderbeut u vendos në Horën e e Arbëreshëve në Sicili më 30 gusht 2024 dhe është një dhuratë e mërgimtarëve shqiptarë për arbëreshët, në shenjë mirënjohje për ruajtjen e kulturës, gjuhës e traditës arbërore për më shumë se pesë shekuj.

Shtatorja madhështore e Skënderbeut është vepër artistike e skulptorit nga Prishtina, Gëzim Muriqi.

7. Videoklipi « Nata e qefit » e grupit muzikor " Hareja".



Të dashur miq kemi kënaqësin që të prezentojm për ju " Nata e qefit" në Gjenev.
FALEMINDERIT HTV për realizimin e saj!
Një falenderim të madh edhe për Z.ZENEL JUSUF! që me shumë dashni na priti e shtrroi sofrën në konakun e tij " Brasserie Nouvelle" Rue de Lyon 96 1203 Gjenev



Të dashur miq ndëgjim të këndshëm me këngën "NATA E QEFIT" nga "HAREJA" Gjenevë ... Afficher la suite



youtube.com
NATA E QEFIT NE GJENEVE



Me iniciativë të artistëve Hekuran Krasniqi dhe Elion Krasniqi u mundësua falas inçizimi i videoklipit të parë të grupit muzikor " Hareja". Inçizimi u bë në studion "LMN Production" dhe xhirimet nga ekipi i "Heki TV" te « Brasserie Nouvelle » me pronar Zenel Jusufi, të cilët i falënderojmë përzemërsisht.

Nga viti 2021 e deri sot, të gjitha këngët e grupit muzikor " HAREJA", janë inçizuar në studio LMN dhe janë aranzhuar nga Elion Krasniqi në baza vullnetare.

Falënderim për Alb'swiss_TV, Prointegra.ch dhe albinfo.ch që përcjellin dhe publikojn aktivitetet tona dhe nga të cilat kemi huazuar disa imazhe shoqëruese të këtij raporti dhe disa shkrime të tyre.

Gjenevë, 10 tetor 2024

Sekretar
Blerim Bunjaku

Kryetar
Nasuf Nuhiu